ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 214-26-7352-2-1-1

Sa i përket tenderit për *"Zgjerimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit te Menaxhimit te Radhës"*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	PBC SH.P.K.
NUI	810845985
Adresa	Rruga Bekim Fehmiu, 91
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	044467467
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Selmani
Adresa elektronike	bs@pbc.group
Data e parashtrimit të ankesës	25.11.2026

Vulosur nga: PBC SH.P.K.
Data: 25.11.2026 14:47:57
Lëshuesi: rTrust Issuing CA
ID: EVC5-NH8Z-PKDG-WAXH-XP3V

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:
Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:
Ankesa i përket grupeve:

"Zgjerimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit te Menaxhimit te Radhës"
Njoftimi për kontratë: 03.09.2026;
Kërkesa për informata shtesë: 23.09.2026;
Informata dhe sqarime shtesë lidhur me Dosjen e Tenderit (DT): 29.09.2026;
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: 13.10.2026;
Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) – Anulimi i procedurës së prokurimit: 17.11.2026;

Kërkesa për rishqyrtim: 18.11.2026;
Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim: 23.11.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Më datë 18.11.2026, në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (AK), duke kundërshtuar vendimin e AK-së. Më datë 23.11.2026, AK ka nxjerrë vendimin për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim.

Meqenëse nuk pajtohemi me vendimin dhe arsyetimin e dhënë nga AK, si dhe konsiderojmë se pretendimet tona ankimore nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së, parashtrojmë këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Bashkëlidhur kësaj ankese, paraqesim kopjen e kërkesës për rishqyrtim dhe kopjen e vendimit të AK-së për refuzimin e saj.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji për Prokurimin Publik (LPP):

- Neni 7 i LPP-së;
- Neni 56.3 i LPP-së;
- Neni 59.4 i LPP-së;
- Neni 62 i LPP-së.

Rregullorja për Prokurimin Publik (RRPP):

- Neni 40.2 i RRPP-së;
- Neni 40.12 i RRPP-së;

- Neni 43.1 i RRPP-së;
- Neni 43.5(b) i RRPP-së.

Dispozitat e zbatuara ose të interpretuara gabimisht nga AK:

- Neni 72 i LPP-së;
- Neni 4 i RRPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PBC parashtron ankesë pranë OSHP-së për të njëjtat pretendime ankimore të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, duke kundërshtuar njëkohësisht vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kësaj kërkese.

Kundërshtimi i vendimit të Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim

- Autoriteti Kontraktues, në vendimin për eliminimin e ofertës sonë, u referohet **nenit 59 dhe nenit 72 të LPP-së**, si bazë ligjore për eliminimin e ofertës.
- Ndërsa në vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues mbështetet në **nenin 4 të RRPP-së**, për të arsyetuar eliminimin e ofertës sonë.

Përveç faktit se eliminimi i ofertës sonë nuk gjen mbështetje ligjore në dispozitat e lartpërmendura, **arsyetimet e paraqitura në të dyja vendimet janë kontradiktore dhe krijojnë dyshime të bazuara për një qasje tendencioze të Autoritetit Kontraktues ndaj ofertës sonë**, për faktet dhe arsyet e mëposhtme:

> **a) Neni 59 i LPP-së**, të cilit Autoriteti Kontraktues i referohet në vendimin për eliminimin e ofertës sonë, përcakton pikërisht **të kundërtën e mënyrës se si ka vepruar AK-ja në rastin konkret.**
>
> Nëse i referohemi paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-së, të cilin Autoriteti Kontraktues ka obligim ligjor ta zbatojë gjatë vlerësimit të ofertave, aty përcaktohet shprehimisht, citojmë:
>
> *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."*
>
> Në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, **Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar kriteret e vlerësimit pas dorëzimit të ofertave, duke përdorur si kriter eliminues çmimet për njësi të parashikuara në përllogaritjet e tij të brendshme**, të cilat nuk kanë qenë **të publikuara** dhe **as të përcaktuara** si **kufij minimalë** apo **maksimalë të detyrueshëm në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.**

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues **ka anashkaluar faktin se oferta jonë financiare prej 194.030,12 € është nën vlerën e përgjithshme të parashikuar të kontratës prej 200.000,00 €**, e cila ka qenë e publikuar në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

Pikërisht në këtë mospërputhje ndërmjet kritereve të publikuara paraprakisht dhe kritereve eliminuese të zbatuara gjatë vlerësimit, si dhe në mënyrën kontradiktore të arsyetimit të vendimeve të AK-së, **mbështeten dyshimet tona për një qasje tendencioze të Autoritetit Kontraktues ndaj ofertës sonë.**

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues, në vend që ta zbatojë nenin 59 të LPP-së, zbatimi i të cilit është i **detyrueshëm gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, i është referuar kësaj dispozite për të arsyetuar një veprim që bie në kundërshtim me vetë përmbajtjen e saj.**

b) Neni 72 i LPP-së, të cilit Autoriteti Kontraktues gjithashtu i referohet në vendimin për eliminimin e ofertës sonë, rregullon çështjen e dokumentacionit dhe informacionit shtesë.

Mirëpo, në rastin konkret, **Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar në vendimin për eliminimin e ofertës sonë asnjë mangësi, pasaktësi apo mospërputhje në dokumentacionin e dorëzuar në kuadër të ofertës sonë, që do të arsyetonte zbatimin e kësaj dispozite ligjore.**

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues **i është referuar një dispozite ligjore që nuk rregullon arsyen konkrete të eliminimit të ofertës sonë dhe, për pasojë, nuk ofron asnjë mbështetje juridike për vendimin e marrë.**

c) **Neni 4 i RRPP-së,** të cilit Autoriteti Kontraktues i referohet në vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim, rregullon administrimin e përgjithshëm të procedurave të prokurimit publik, përfshirë përcaktimin e kushteve të kontratave, krahasimin efektiv të ofertave dhe sigurimin që çmimet e kontraktuara të mos jenë më të larta se çmimet e tregut.

Mirëpo, në rastin konkret, **asnjë nga dispozitat e nenit 4 të RRPP-së nuk e autorizon Autoritetin Kontraktues të ndryshojë apo të shtojë kriteret e vlerësimit pas dorëzimit të ofertave, duke përdorur si kritere eliminuese çmimet për njësi të parashikuara në përllogaritjet e tij të brendshme**, **të cilat nuk kanë qenë të përcaktuara dhe as të publikuara paraprakisht në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.**
Për më tepër, kjo dispozitë nuk mund të interpretohet dhe të zbatohet në kundërshtim me nenet 56.3 dhe 59.4 të LPP-së, si dhe nenet 40.2 dhe 40.12 të RRPP-së.

Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues, ashtu sikurse në rastin e neneve 59 dhe 72 të LPP-së, **i është referuar një dispozite që nuk ofron mbështetje juridike për eliminimin e ofertës sonë për arsyen e deklaruar dhe në rrethanat konkrete.**

Pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim, të cilat mbeten të pandryshuara, në përputhje me kërkesat ligjore, janë si në vijim:

PRETENDIMI 1 – Eliminimi i ofertës në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenet 7, 56.3 dhe 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si dhe nenet 40.2 dhe 40.12 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP)**, sepse:

Ka eliminuar ofertën tonë si të papërgjegjshme, me arsyetimin se **çmimet e ofertuara për tri pozicione në tabelën e çmimeve janë më të larta se vlerat e parashikuara nga Autoriteti Kontraktues.**

Diferencat e konstatuara nga AK-ja mund të jenë të sakta në raport me preventivin e saj të brendshëm. Megjithatë, **këto vlera nuk kanë qenë të njohura për operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të ofertave**, **pasi nuk janë publikuar në Njoftimin për Kontratë apo në Dosjen e Tenderit dhe as nuk janë përcaktuar si kufij maksimalë, tejkalimi i të cilëve përbën shkak për eliminimin e ofertës.**

Rrjedhimisht, përdorimi i këtyre vlerave si kriter eliminues përbën shtim të kritereve gjatë procesit të vlerësimit, në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura, për faktin se:

- Në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit është përcaktuar vlera e përgjithshme e parashikuar e kontratës prej **200.000,00 €**, ndërsa nuk janë përcaktuar çmime maksimale të detyrueshme për secilin pozicion.
- Oferta financiare e dorëzuar nga ne është 194.030,12 €, përkatësisht 5.969,88 € (2,98%) nën vlerën e përgjithshme të parashikuar të kontratës.
- Në dokumentacionin e tenderit **nuk është përcaktuar asnjë kriter** sipas të cilit tejkalimi i vlerës së brendshme të parashikuar nga AK-ja për një pozicion të caktuar rezulton në shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme.
- Në vendimin B42, **AK-ja nuk ka identifikuar dispozitën konkrete ligjore apo kërkesën e Dosjes së Tenderit që e autorizon eliminimin** për shkak të këtyre diferencave, por është mbështetur në krahasimin e çmimeve të ofertuara me preventivin e saj të brendshëm.
- Sipas nenit 56.3 të LPP-së dhe nenit 40.2 të RRPP-së, Autoriteti Kontraktues nuk mund të përjashtojë një operator ekonomik mbi bazën e kërkesave ose kritereve që nuk janë përcaktuar paraprakisht në dokumentacionin e tenderit dhe as të shtojë apo ndryshojë kritere gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave.

Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar një bazë eliminimi që nuk rezulton të jetë përcaktuar paraprakisht në dokumentacionin e tenderit, duke cenuar parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe vlerësimit sipas kritereve të shpallura.

Për rrjedhojë, **kërkojmë shfuqizimin e vendimit B42 për eliminimin e ofertës së tonë dhe kthimin e aktivitetit të prokurimit në rivlerësim**, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

PRETENDIMI 2 – Anulimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me dispozitat ligjore

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si dhe nenet 43.1 dhe 43.5(b) të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP)**, sepse:

Ka anuluar aktivitetin e prokurimit pas hapjes së ofertave, përmes vendimit B58, datë 17.11.2026, me arsyetimin se asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm, ndonëse **ky konstatim mbështetet në eliminimin e kundërligjshëm të ofertës së PBC.**

Sipas nenit 62 të LPP-së, përfundimi i aktivitetit të prokurimit pa dhënien e kontratës lejohet vetëm në rrethanat e përcaktuara me ligj, ndërsa neni 43.5(b) i RRPP-së përcakton anulimin e procedurës pas hapjes së ofertave kur asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm.

Po ashtu, neni 43.1 i RRPP-së kërkon që **anulimi i aktivitetit të prokurimit të mbështetet në arsye faktike dhe juridike të dokumentuara.**

Në rastin konkret, siç është argumentuar në Pretendimin 1, eliminimi i ofertës së PBC shtë mbështetur në çmime të brendshme për njësi, të cilat nuk janë publikuar dhe as përcaktuar si kritere eliminuese në dokumentacionin e tenderit.

Rrjedhimisht, **eliminimi i ofertës sonë është i kundërligjshëm dhe për pasojë, nuk qëndron as konstatimi se asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm**, mbi të cilin Autoriteti Kontraktues ka mbështetur vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit.

Përfundimisht, **vendimi B58 nuk mbështetet në një konstatim të ligjshëm të përmbushjes së kushteve për anulimin e procedurës pas hapjes së ofertave**, pasi bazohet në eliminimin e kundërligjshëm të ofertës sonë.

Për rrjedhojë, **kërkojmë shfuqizimin e vendimit B58 për anulimin e procedurës, së bashku me vendimin B42 për eliminimin e ofertës së PBC, dhe kthimin e aktivitetit të prokurimit në rivlerësim**, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

KËRKESA DREJTUAR OSHP-së

Bazuar në faktet, argumentet dhe dispozitat ligjore të paraqitura në këtë ankesë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që:

- Ta aprovojë ankesën e PBC SH.P.K. në tërësi si të bazuar;
- Ta shfuqizojë vendimin e AK-së të datës 23.11.2026 për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;
- Ta shfuqizojë vendimin B42 për eliminimin e ofertës së PBC SH.P.K.;
- Ta shfuqizojë vendimin B58 të datës 17.11.2026 për anulimin e procedurës së prokurimit;
- Ta urdhërojë Autoritetin Kontraktues që aktivitetin e prokurimit ta kthejë në rivlerësim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë, Dosjen e Tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi;

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale dhe jomateriale që i janë shkaktuar ose që mund t'i shkaktohen parashtruesit si pasojë e shkeljeve të pretenduara do të përcaktohen pas realizimit të një ekspertize përkatëse financiare.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*